



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 12.5.2023

Nr: 500

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

**MIRATIMIN E LISTËS EMËRORE TË SHTETASVE TË CILËT MUND TË EMËROHEN KRYESISHT
NGA KQZ PËR PLOTËSIM TË VAKANCËS NË KZAZ, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E
QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronja "ç", e pika 2, neni 29, pika 5, neni 30, neni 31 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, neni 3, pika 7, të vendimit nr. 5, datë 20.11.2020, të Komisionit Rregullator "Për organizimin dhe funksionimin e Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor", si dhe udhëzimit nr. 2, datë 5.12.2020, të Komisionit Rregullator "Për caktimin e procedurave të përzgjedhjes dhe trajnimit të shtetasve që mund të emërohen kryesisht për plotësimin e vakancës në Komisionet e Zonës së Administrimit Zgjedhor dhe Komisionet e Qendrave të Votimit", Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V Ë R E N:

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në zbatim të nenit 5, pika 1, të udhëzimit nr. 2, datë 5.12.2020, të Komisionit Rregullator "Për miratimin e procedurave të përzgjedhjes dhe trajnimit të shtetasve që mund të emërohen kryesisht për plotësim të vakancës në KZAZ dhe KQV", publikon në media jo më vonë se 140 ditë para datës së zgjedhjeve, njoftimin për shprehje interesi nga shtetas të cilët janë të gatshëm të ushtrojnë detyrën e anëtarit apo sekretarit të KZAZ-së.

Në faqen zyrtare të KQZ-së është publikuar kërkesa për shprehje interesi nga shtetas që janë të gatshëm të ushtrojnë detyrën e anëtarit apo sekretarit të KZAZ-së. Në nenin 5, pika 2, shkronja "c", të udhëzimit të sipërcituar, përcaktohet afat 130 ditë para datës së zgjedhjeve për

Data: 12.5.2023 Nr: 500
Ora: 12:00



"Për miratimin e listës emërore të shtetasve të cilët mund të emërohen kryesisht nga KQZ për plotësim të vakancës në KZAZ, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023"

shprehjen e interesit për të qenë anëtar/sekretar KZAZ. Duke qenë se aplikimet në afatin e përcaktuar ishin në numër shumë të vogël, u pa e arsyeshme që faqja e aplikimeve të vijonte të ishte e hapur.

Nga administrimi i aplikimeve, rezulton të kenë shprehur interes për të qenë anëtar/sekretar KZAZ-je 41 (dyzet e një) shtetas, shoqëruar me kërkesë dhe dokumentacion përkatës.

Nga verifikimi i kryer sipas përcaktimeve të nenit 6, pika 2, të udhëzimit nr. 5, datë 20.11.2020 të Komisionit Rregullator, dokumentacioni i paraqitur dhe nga verifikimi i të dhënave rezulton se këta shtetas plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 30, dhe 31, të Kodit Zgjedhor.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “ç”, e pika 2, nenin 29, pika 5, nenin 30, nenin 31 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 3, pika 7, të vendimit nr. 5, datë 20.11.2020, të Komisionit Rregullator “Për organizimin dhe funksionimin e Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor”, si dhe udhëzimit nr. 2, datë 5.12.2020, të Komisionit Rregullator “Për caktimin e procedurave të përzgjedhjes dhe trajnimit të shtetasve që mund të emërohen kryesisht për plotësimin e vakancës në Komisionet e Zonës së Administrimit Zgjedhor dhe Komisionet e Qendrave të Votimit”,

V E N D O S:

1. Miratimin e listës emërore të shtetasve të cilët mund të emërohen kryesisht nga KQZ për plotësim të vakancës në KZAZ, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI